

**Më 13 nëntor 2005
Kisha shpalli i “lumtur”:**

Vëlla Sharlin (Charles de Foucauld)

Sot të shumë janë ata që gjejnë te vëllai Sharl një model të sigurt për jetuar **dashurinë për Hyjin dhe për njerëzit.**

Itinerar shpirtëror i vëllait Sharl të Jezuit

Sharl de Fuko lindi në Strasburg në vitin 1858. Ai mbeti shumë herët një fëmijë jetim dhe i vrarë shpirtërisht. Ishte ende gjashtë vjeç, kur nëna i vdes në mars të vitit 1864 dhe i ati disa muaj më pas. Në kujtimet e tij të fëmijërisë, ai do të përfjethë përherë me mall dhëmbshurinë me të cilën e rrethonte nëna e tij.



Përjeton një mituri të vështirë dhe humb fenë; zhytet në një jetë kënaqësish dhe parregullsish, për të mposhtur ndoshta trishtimin që e mbyste.

« Beja keq , por këtë as e aprovoja dhe as e doja. Ti më bëjë të ndjeja një boshllëk të dhimbshëm , një trishtim që nuk e kisha provuar kurrë deri atëherë, që me vinte çdo mbremjë kur gjendesha i vetmuar në apartamentin tim »

Mirëpo në thellësinë e zemrës së tij mbetet një trishtim, një zbrazëti që asgjë nuk mund të mbushë. Më vonë nën dritën e fesë së rigjetur, ai do të kuptojë se kjo zbrazëti, ky trishtim ishin shenja të pritjes së pafund dhe të heshtur të Perëndisë, që nuk ia kishte kthyer shpinën.

“Qëkur isha pesëmbëdhjetë-gjashtëmbëdhjetë vjeç, leximet, që më pëlqenin shumë, kishin arritur të zhduknin prej meje çdo fe; nuk pranoja asnjë doktrinë filozofike, duke mos gjetur asnjë prej tyre të themeluar mbi baza të qëndrueshme, qëndroja në dyshim të plotë, sidomos larg fesë katolike, dogmat e së cilës, sipas meje, vritnin thellë arsyen.” (Letra Henri Duveyrier, 21.2.1892)

Ishte 22 vjeç, oficer, kur ai u dërgua në Algjeri. Atje mahnitet duke zbuluar horizonte të reja. Pas tri vitesh, largohet prej ushtrisë dhe rrezikon duke ndërmarrë një ekspeditë në Marok. Gjatë këtij udhëtimi ai mirëpritet dhe mbrohet disa herë nga myslimanë shumë fetarë, të cilët bëhen miqtë e tij. Dëshmia e besimit të tyre e bëjnë të mendohet aq sa në vetvete i lind pyetja : a ekziston Perëndia?

Kur kthehet në Francë, familja e tij e krishterë e mirëpret me mall, duke u treguar e matur me të, në veçanti kushërira e tij Mari de Bondi. Ai vihet në kërkim. Falë providencës ai takon një prift, që do të jetë për të një atë dhe një mik : abati Hyvëlen/Hyvelin. Në tetor të vitit 1886, në moshën njëzet e tetë vjeç rikthehet në fenë e tij.

Atëherë ai zbulon Zotin si një atë shumë të afërt dhe plot dhëmbshuri, që e ka pritur parreshtur fëmijën e vet. Ekzistenca e tij shndërrohet tërësisht dhe, që sot e tutje ai kërkon sesi t'i përgjigjet me tërë jetën e tij kësaj dashurie të pafund të Hyjit.

Një pelegrinazh në Tokën e Shenjtë ia zbulon fytyrën e Jezusit të Nazaretit, biri i Zotit, ardhur në mishin tonë, që ka bërë jetën e thjeshtë të një zeytari në fshat për tridhjetë vjet. Kjo varfëri e kjo përvujtëri bëjnë jehonë thellë në qenien e tij si një thirrje. Ai shkruan për këtë :



“Më në fund, jam i etur të jetoj... siç e kam parashikuar, parandier, duke ecur nëpër rrugët e Nazaretit që shkelën këmbët e Zotit tonë, zëjtari i varfër, i humbur në poshtërim e në errësirë”

Përvijohet rruga, por ajo do të jetë e gjatë dhe e stuhishme. Vëllai Charl kalon së pari shtatë vjet në manastirin “Notre-Dame des Neiges”, pastaj qëndron katër vjet në Nazaret, ku jeton si eremit para derës së një kuvendi të Klariseve.

Ai kalon gjithashtu shumë kohë duke përsiatur Ungjillin...dhe shumë shpejt kjo fjalë e Zotit do t’i drejtohet atij dhe ai do t’i përgjigjet.

« Më duket se nuk ka fjalë të Ungjillit që të më ketë tronditur aq thellë dhe të ketë shndërruar aq shumë jetën time sa kjo:

“Gjithçka që ju e bëni njërit prej atyre të vegjëlve, ma bëni mua”.

Nëse mendojmë se këto fjalë janë ato të së Vërtetës së pakrijuar, ato të gojës që ka thënë: “Ky është trupi im...Ky është gjaku im...”me çfarë forcë jemi shtyrë për të kërkuar e për të dashur Jezusin te këta të vegjëlit » (Letra Louis Massignon, 1 gusht 1916)

Këto fjalë e shtynë të braktisë vetminë e tij për të shkuar drejt tokave më të lëna pas dore, ku Jezusi e pret te të gjithë ata dhe ato, që jetojnë në vuajtje dhe varfëri. Ai dëshiron gjithashtu t’u sjellë atyre që nuk e njohin, këtë dashuri të Zotit, që digjet në të si zjarr.

Vëllai Charl ka rizbuluar atë që thoshte tashmë Shën Joan Gojarti/ Krizostomë në shekujt e parë të krishterizmit: duhej të ishin po aq të kujdesshëm ndaj pranisë së Jezusit tek i varfri sa edhe ndaj pranisë së tij në Eukaristi.

Ky parapëlqim i Zotit për të varfrit, për mëkatarët, për të fundit, e shpëput atë nga jeta e tij në eremitore, për t’ia dhuruar atë, gjithnjë e më shumë me dashuri Zotit të tij, por duke treguar përherë mikpritje, gatishmëri, bashkëndarje vëllazërore me më nevojtarët.

Në vitin 1900, ai largohet përfundimisht nga Nazareti, kalon disa muaj në abacinë “Notre-Dame des neiges”, që të bëhet prift. I shuguruar më 9 qershor 1901 nga ipeshkvi i Vivjesë/Viviers, niset disa muaj më vonë për Algjeri dhe vendoset në oazën e Saharasë në Beni-Abbès, në kufi me Marokun.

Beni Abbès


Ai nuk ndërton një eremitore, por një “vëllazëri“, d.m.th. një shtëpi, dera e së cilës është gjithmonë e hapur për të gjithë ata që vijnë pa dallim nënshtetësie race ose religjioni. Ai shkruan :

“Nga ora 4.30 e mëngjesit deri në 8.30 të mbrëmjes njerëzit që vinin, të varfër, skllevër dhe mysafirë nuk më lënë asnjë çast...”

« Të jesh bamirës, i butë, i përvuajtur, me të gjithë njerëzit: Jezui na ka mësuar të shkojmë «si qingja ndër ujqërit»

(Letra M. de Bondi, 1902)

Në kapelën e Beni Abbès pikturon figurën e Takimit të Virgjreshës Mari me Elizabetën. Ai vendosi këtë festë



si “festë e pajtores” për vëllezërit dhe motrat e vogla që duhen ta” sjellin Jezuin për të shenjtëruar popujt duke sjellë në mes tyre JEZUIN në heshtje. sikurse Maria shenjtëroi shtëpinë e Gjonit duke çuar atje JEZUIN.

Kanë kaluar tashmë tre vjet që kur Vëllai Sharl është vendosur në Beni-Abbès.

Atje dëgjon të flitet për një popull të varfër, tuaregët, dhe se është shumë e vështirë për të shkuar deri atje. Në vitin 1904, miqtë e tij oficerë i japin mundësinë të udhëtojë dhe të hyjë në kontakt me ta. Kështu, niset përsëri për udhë.

Për më shumë tre muaj ai ecën nëpër shtigje të lodhshme të shkretëtirës për të arritur në malet e ashpra të Hogarit, ku jetojnë si nomadë grupe të vogla tuaregësh. Sapo arrin atje, ai ndien brenda vetes një forcë që e shtyn për t’u vendosur në mes tyre. Por këto fise kanë një mosbesim të madh ndaj pushtuesve francezë dhe vetëm pas një viti Musa Ag Amastane, kreu i tyre, e lejon Sharlin të vendoset në Tamanrasset. I vetëm, pa mbrojtje, mbështetet te mysafirët e tij dhe vendoset në një shtëpi prej balte, të ndërtuar brenda disa ditësh.

«Jam këtu jo për t’i konvertuar tuaregët, por për të bërë përpjekje për t’i kuptuar...Unë jam i sigurt se Zoti ynë do t’i mirëpresë në qiell ata që qenë të mirë e të ndershëm...»

Që në takimet e para me ta, ai fillon të studiojë me pasion gjuhën e tyre. Ai kërkon ta njohë kulturën e tyre, duke qëmtuar me qindra vargje poemash e poezish, të kënduara rreth e rrotull zjarrit në mbrëmje, ku përcillet historia dhe shpirti i popullit tuareg..



Vëllai Sharl ushqen në zemër një dëshirë shumë të madhe : t’u flasë atyre për Jezusin dhe për Ungjillin, por e kupton shumë shpejt se kohët nuk janë pjekur për një shpallje të tillë. Atëherë, vetëm falë një pune me plot durim, miqësi e mirësi, ai mund t’u tregojë atyre se kush është Hyji i tij. Në vitin 1909 ai shkruan :

«Apostolati im duhet të jetë apostolati i mirësisë ; kur të më shohin mua, duhet t’i thonë njëri-tjetrit ‘Meqenese ky njeri është aq i mirë besimi fetar duhet të jetë e mirë’. Në qoftë se më pyesin përse unë jam i butë e i mirë, duhet të them: ‘Sepse jam shërbëtori i një shumë më të miri se unë, sikur ta dinit sesa i mirë është Mësuesi im Jezusi... » Nga Ditari, 1900

Shpërthen lufta e parë botërore në vitin 1914. Dhuna arrin deri në vendet e shkreta të Hogarit. Pothuaj kudo ngrihen fise kundër pushtimit frëng dhe pasiguria rritet.

Vëllai Sharl e di se gjendet në rrethina gjithnjë e më shumë të rrezikshme. I propozojnë që të shkojë për t’u strehuar në një post ushtarak frëng, por ai nuk pranon të braktisë ata që e kanë mirëpritur para dhjetë vitesh e më shumë. Në këto vite janë thelluar miqësia e besimi dhe ai ndihet i lidhur me popullin tuareg nëpërmjet solidariteteve njerëzore shumë të forta.

“Zoti im Jezu, që keni thënë: ‘Askush nuk ka një dashuri më të madhe sesa ai që jep jetën për miqtë e tij...’ dëshiroj me gjithë zemër ta jap jetën time për ju, jua kërkoj këtë gjë menjëherë... Hyj im, falini armiqët e mi, jepuni atyre shpëtimin...” (Meditimi 1916)

“Të jetosh të sotmen sikur të vdisja martir këtë mbrëmje”

Tërë jetën e tij ai ka kërkuar të ndjekë dhe të imitojë këtë Jezus të Nazaretit, që një ditë i rrëmbeu zemrën dhe tani dëshiron ta ndjekë atë deri te Mundimi dhe vdekja e tij, për t’i dhënë Jezusit provën e dashurisë më të madhe.

Ishte mbrëmja e 1 dhjetorit 1916, kur një grup rebelësh e morën peng. Duket se ata nuk kishin ndërmend ta vrisnin, por në një çast paniku, ai që e ruante, e qëlloi nga shumë afër dhe kështu vëllai Sharl ra viktimë e dhunës si shumë të tjerë në ato vitet e luftës.



Ai vdes i vetëm si fara e grurit, por kjo është shenjë shprese, që vëllazëria njerëzore është më e fortë se të gjitha urrejtjet që sfilisin dhe përçajnë popujt. Pesëmbëdhjetë ditë më vonë kreu tuareg Musa Ag Amastane, që ishte bërë miku i tij dhe që ishte një mysliman i përsëritshëm, i shkruan motrës së vëllait Sharl:



“ Sharl, marabu arabisht d.m.th.njeriu i Zotit, nuk ka vdekur vetëm për ju, por edhe për ne të gjithë. Zoti i dhëntë mëshirë dhe u takofshim me të në parajsë!”

SOT cili është mesazhi i tij?

Ai dëshmon me jetën e tij që Dashuria për Zotin shkon bashkë me dashurinë për të gjithë njerëzit, dhe që **Dashuria e përgjithshme** fillon nga dashuria e atyre **që janë afër neve** dhe do të jetë **Falas**, pa interes .

Sharl de Fuko na ka lënë një vepër të pambaruar. Sfidat e mëdha të ungjillizimit mbeten të hapura përpara nesh:

- sfida e butësisë dhe e jo-dhunës ungjillore.
- sfida e dashurisë vëllazërore për të jetuar në gjirin e komunitetit.
- sfida e një vëllazërie të vërtetë në shkallë planetare, përtej çdo shfaqjeje të urrejtjes etnike dhe hakmarrëse, përtej çdo ndjenje të superioritetit
- Papa Pali VI në enciklikën e tij *Populorum progressio*, flet për veprën e inkulturimit të kryer nga vëllai Sharl. “Në shumë rajone misionarët kanë qenë pionierët e përparimit material si edhe të zhvillimit kulturor. Mjaft të kujtojmë shembullin e atit Sharl de Fuko, i cili në sajë të dashurisë së tij për vëllezërit, u gjykua i denjë të quhej “vëllai i gjithmbarshëm”, dhe atij i detyrohemi për hartimin e një fjalori të çmuar në gjuhën tuareg



Dy faqe të Fjalorit

Vëllai Sharl ka vdekur vetëm si fara e grurit që jepet fryte të shumta vetëm kur kalbet, por dishepujt e tij gjetën frymën ungjillore në shkrimet e sidomos në jetën e tij.

Sot në Shqipëri jetojnë Motra e vogla e Jezusit dhe Motrat e Lëvizjes Kontemplative Misionare « P.Charles de Foucauld »

Motra e vogla e Jezusit janë katër dhe banojnë në një vëllazëri në Tirane : jeta e tyre kontemplative në mes të njerëzve bën që të kanë kontakte me persona të kulturave, besimeve fetare e shtresave shoqërore të shumëllojshme, me dëshirë të zjarrte u tregojnë dashurinë e Hyjit, më shumë me qëndrimin.

« Bashkimi » kjo fjalë shpreh misionin e Vëllazërisë së Motrave të Vogla në Kish

Motrat e Lëvizjes Kontemplative Misionare « P.Charles de Foucauld » jetojnë në Gostimë afër Elbasanit, jetë kontemplative si një familjë, midis familjave që janë me tradita myslimane

Lutje vetëbraktisjeje

Ati im

Po lëshohem në duart e tua,
bëj me mua si të pëlqen ty.
Çfarëdo që të bësh me mua,
unë të falënderoj.

Jam i gatshëm për gjithçka,

pranoj gjithçka.

Vetëm të bëhet
vullneti yt në mua,
dhe në të gjitha krijesat e tua.
Nuk dëshiroj asgjë tjetër Zoti im.
Po e lë shpirtin tim në duart e tua.
Po ta dhuroj Zoti im

me gjithë dashurinë e zemrës sime,

sepse të dua
dhe dashuria kërkon prej meje
të dhurohem,
të lëshohem në duart e tua,
me besim të pamasë,
sepse je Ati im.

Vëllai Charl i Jezusit

